

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot në datën 13.11.2017, në sallën e Bibliotekës nr.2, Rruga “Tefta Tashko Koço”.

Morën pjesë në këtë takim, Administratorja e Njesisë nr.1, znj.Trëndelina JAKU dhe qytetarë nga gjithë Njësia Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë.

I deleguar nga Bashkia Tiranë, Z.Erind BEJKO, Drejtor I Përgjithshëm I Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimit me Njësitë Administrative dhe Emergjencave Civile.

**Rendi I Ditës: “Dëgjese publike për buxhetin e vitit 2018 për njësinë Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë”**

Znj.Trëndelina Jaku, Administratore e Njesisë Nr.1, mban një fjalim pershëndetës dhe falenderues për të gjithë pjesëmarrësit dhe për punën dhe investimet e kryera në Njësinë nr.1, gjatë këtyre dy viteve.

Z.Erind Bejko fillon të relatojë mbi investimet e kryera në dy vite në Njësinë nr.1, në një vlerë totale investimesh prej 340 milion lekë, konkretisht për:

- Rikualifikimin urban të 2 blloqeve dhe rehabilitimin e Rr.”Dhimitër Kamarda”
- Rikonstrukcioni i Trotuareve dhe rrugës “Ali Shefqeti”
- Rehabilitim dhe instalim i sistemit të ngrohjes në shkollën “1 Maji”
- Ndërtim Godina banimi në territorin e ish-repartit Ushtarak, Shkozë, për komunitetin e që preken nga projekti i rehabilitimit të Lumit të Lanës “Bregu i Lumit”
- Rikonstrukcion i Kopshtit 24
- Rikonstrukcion Kopshti 56
- Çerdhe nr.14
- Çerdhe nr.50
- Çerdhe e re të ish Fonderia Shkozë

Z.Erindi Bejko: Të gjitha këto investime janë kryer falë gjetjes së mekanizmave dhe mbledhjes së taksave vendore, të cilat sot aktualisht arrijnë të mbidhen në masën 95-97 %, ndërkohë që nuk kemi rritje taksash. Po kështu, ka filluar mbjellja e pemëve në Pyllin Orbital, i cili, do të përcaktojë kufijtë e zonës urbane dhe atë rurale në qytetin e Tiranës. Po kështu, taksat e infrastrukturës arsimore, deri tani nuk ka shkuar për investime në këto objekte, pasi ne (Bashkia Tiranë) kemi një shpenzim shumë të madh për Politikën Sociale të Bashkisë Tiranë (kopësht, çerdhe, kosto e 1 femije sot është 160 lekë/dite, ndërkohë që vlera reale shkon 650 lekë /ditë.)

Në muajin Mars 2018 Taksa e Infrsaturkturës Arsimore do të fillojë të shkojë në destinacionin e saj, pra për ndertimin e shkollave të reja. Buxheti per vitin 2018 per Njëshinë nr.1 do të jetë një buxhet ambicioz, i cili ka një rritje pre 15%, dhe investimet do të jenë konkretisht në këto projekte, të cilat tashmë janë gati:

1. Thellim dhe pastrimi i kanalit të hapur tek ish-Liqeni Shkozë
2. Rikualifikim i ndriçimit në rrugën “Idriz Dollaku” e “Haxhi Sabri Koçi”
3. Rehabilitimi i Qendres Shëndetsore Shkozë
4. Rikonstruksion i bllokut të rrugëve që kufizohet nga rrugët “Arben Lami”-“Ali Shefqeti”-“Aleksanër Konda”-rruga që lidhe “A.Konda “ me “Fehmi Ibrahim”
5. Sistemim asfaltimi i rrugëve në Njësinë Administrative Nr.,1
6. Rikonstuksion dhe shtesë në Shkollën 9-vjeçare “Ali Demi”
7. Kopshti Ylber
8. Ndërtim tregjesh fruta-perime
9. Rehabilitimi i lulishteve dhe hapesirave të gjelbërta
10. Rikonstruksion i godinës së Njësisë Administrative

### **Diskutime:**

Pas këtij prezantimi të projekt -buxhetit 2018, fjalën e kërkon **Z.Bashkim Suli** , Ndërlidhës me komunitetin në bllokun e pallateve në rrugën “Idriz Dollaku”, i cili tha:

“Falenderojmë Bashkinë për punën e mirë që ka bërë, ndonëse ende ka shumë probleme , në zonën që jam Ndërlidhës, probleme me sistemimin e rrugëve, Ndricimi i cili është përfshirë në këtë project buxhet, klanalizime, gjelberime etj. Në të ardhmen të merret parasysh edhe ndertimi i një çerdhe dhe kopsht për bllokun e pallateve në rrugën “Idriz Dollaku”

Fjalën e **kërkon Z.Dritan Aga**, ndërlidhës me komunitetin në zonën e Shkozës i cili pyeti nëse për këto investime/projekte janë parashikuar edhe shpronësime të mundshme , të cilat mund të hapin plagë sociale, sikundër ajo që ndodhi në Shkozë, për rehabilitimin e lumit të Lanës loti II “Unaza e jashtme e Tiranës”

### **Z.Bejko thekson që nuk do të kete asnje investim pa u kryer shpronësimet, konform kuadrit ligjor në fuqi**

**Z.Sami Gërbolli**, ndërlidhës i lagjes Shkozë pyet nëse për zonën e tij përveç investimeve të furnizimit me ujë a do të ketë edhe investime për sistemimin e kanalizimit e ujrave te zeza në këtë zone.

**Z.Bejko** thekson që në këtë projekt buxhet kjo nuk është përfshirë, por nëse do të ekzistojë një mundësi , fonde që mund të teprojnë nga investimet e mësipërme, do të destinohen për këtë problem.

Mbledhja u mbyll me një falenderim për të gjithë pjesëmarrësit!

